



Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren
University "Ukshin Hoti" Prizren

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti Prizren "UKSHIN HOTI"	
Pranuar më dt. 11.05.2022	
Zyra e pranimit	Nr. i protokollit
308	01-203

KËSHILLI DREJTUES

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Kryesues i Këshillit Drejtues
Prof. Asoc. Dr. Arif Murrja

Prizren, më 11.05.2022

Në mbështetje të nenit 17, paragrafi 3 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, sipas referencës nr. 04-V-621 të datës 30 maj 2013, Këshilli Drejtues i Universitetit të Prizrenit, duke vendosur në lidhje me kërkesën me nr. prot. 02 – 132, të datës 04.04.2022, në mbledhjen elektronike të mbajtur më 12.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet pjesërisht kërkesa me nr. prot. 02 – 132, e datës 04.04.2022, parashtruar nga Prof. Ass. Dr, Ismet Bujupaj, Profesor në Fakultetin Filologjik, për kompensim të pagave pas pensionimit.
2. I njëjti ka të drejtë në realizimin e pagesës përcjellëse në lartësi të tri (3) pagave, sipas mesatares së tri pagave të fundit.
3. Obligohet shërbimi financiar i Universitetit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Këshilli Drejtues, në mbledhjen e mbajtur më 28.03.2022, pasi shqyrtoi dhe diskutoi kërkesën me nr. prot. 02 – 132, të datës 04.04.2022, parashtruar nga Prof. Ass. Dr, Ismet Bujupaj, Profesor në Fakultetin Filologjik, për realizimin e beneficioneve të cekura në Kontratën Kolektive të nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Informacionit dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), e konsideroi të arsyeshme kompensimin e pagave pas pensionimit, ndërsa sa u përket beneficioneve të tjera që burojnë nga Kontrata Kolektive, Këshilli Drejtues i Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, në përputhje me mandatin e vet të përcaktuar me Statutin e Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më: 14.02.2022, e ka formuar komisionin profesional për zbatimin e kontratës kolektive, i cili ka për detyrë që të jep propozimet në lidhje me kërkesat për zbatim të kontratës kolektive, respektivisht të shqyrtoje mundësin dhe menyren e zbatimit të kontratës kolektive nga ana e Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, pas shqyrtimit të raportit të komisionit do të marrë vendim lidhur me Kontratën Kolektive. Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi lejohet e drejta e ankesës në përputhje me nenin 185 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren.

Vendimi i dërgohet:

- Këshillit Drejtues;
- Menaxhmentit;
- Zv. Sekretarit të Përgjithshëm;
- Të përmendurit;
- Zyrës së Personelit dhe Zyrës Ligjore;
- Arkivit.

Prof. Asoc. Dr. Arif Murrja

Kryesues i Këshillit Drejtues

